

NJOFTIM MBI ANULIMIN E PROCEDURËS SË PROKURIMIT

Procedurë e hapur për furnizim

Në përputhje me nenin 47 të “Rregullës për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024)

Data: 16.04.2026

I. “Banka Qendrore e Republikës së Kosovës”
Adresa: Rr. “Luan Haradinaj” nr: 2, 10000 Prishtinë

II. Lënda e procedurës së prokurimit:

II.1 Titulli i kontratës: “Furnizim dhe rregullim i ngrohjes qendrore”

II.2 Numërtimi i prokurimit: “BQK 26 024 121”

II.3 Lloji i procedurës: *Procedurë e hapur*

II.4 Lloji i prokurimit: Furnizim

II.5 Numri i tenderëve të pranuar: 0 (zero) ofertues

III. Anulimi i procedurës së prokurimit:

III.1 Data e anulimit : 16.04.2026

III.2 Anulimi i kësaj procedure të prokurimit bëhet në përputhje me Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore, nenin 47, për arsye të mungesës së ofertave të dorëzuara.

IV. Ankesat

Në përputhje me “Rregullën për Prokurimin në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës” (1 dhjetor 2024), respektivisht sipas Neni 48 “Procedura e ankesës”, çdo palë e interesuar¹ mund të bëjë ankesë pranë Bankës Qendrore: Rr. “Garibaldi” 33, 10000 Prishtinë, www.bqk-kos.org, brenda 5 ditësh nga data e shpalljes së këtij njoftimi. Ankesa nga pala e interesuar duhet të përmbajë të gjitha elementet e cekura si në dosjen e tenderit dhe fizikisht duhet të dorëzohet në Arkivin e BQK-së brenda afatit për t’u konsideruar e vlefshme. Pala ankuese duhet të paguajë një tarifë për parashtrim të

¹ “Palë e interesuar”, sipas pikës 1.26 të nenit 2 të “Rregullës për Prokurimin në BQK” cilësohet operatori ekonomik që mund të dëshmojë interes material nga rezultati i një aktiviteti të prokurimit të zbatuar nga Banka Qendrore në raport me një kontratë të prokurimit.

ankesës pranë Bankës Qendrore, vlera e së cilës do të jetë deri në 1% të vlerës së ofertës përkatëse, jo më pak se 100 euro dhe jo më shumë se 2,500 euro. Në të kundërtën refuzohet menjëherë nga ana e BQK-së. Ankesa e parashtruar pa dëshminë e pagesës që duhet të sigurohet nga pala ankuese do të refuzohet që në pranim të parë nga Banka Qendrore.